



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-050
Prishtinë, më 14 dhjetor 2015, ora 10.00

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2015 DHE E VAZHDUAR MË 17 DHJETOR 2015

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi: Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedohet me pikat e rendit të ditës, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës tentuan të dalin para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryetarit të Kuvendit, por ata u penguan nga pjesëtarët e sigurimit.

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Në këto rrethana, kryetari ndërpreu seancën dhe thirri mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

* * *

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, seanca plenare i vazhdoi punimet në sallën alternative.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 84 deputetë.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

* * *

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin Marrëveshjes së kredisë Kosovë-Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK,
8. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Energjinë Termike,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221, Nr.04/L-116 dhe Nr.04/L-194,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
23. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
24. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për emërimin anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE,

25. Shqyrtimi i propozim-Vendimit të Qeverisë për emërimin anëtarëve në Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare – ARKEP,
26. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit,
27. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, dhe
28. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin parlamentar.

* * *

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Melihate Tërmkolli dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë ishin parashtruar katër (4) pyetje parlamentare, mirëpo nuk pati asnjë deputet të interesuar për ta lexuar pyetjen e bërë.

Për sa i takon pyetjeve me shkrim, ministri për Komunitete dhe kthim Dalibor Jevtiq, është përgjigjur në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi, shifra DO-816, të parashtruar me datë 18 nëntor 2015.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 30 nëntor 2015.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari tha se Komisionet e Përhershme Parlamentare, e kanë shqyrtuar Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i kanë paraqitur Raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, Naser Osmani.

Diskutimi i deputetit Naser Osmani është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Margarita Kadriu, Nait Hasani dhe Xhevahire Izmaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4A, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56 dhe 57.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 61.

Deputeti, Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, i tërhoqi amendamentet me numrat: 58 dhe 59.

Grupi Parlamentar “6+” e tërhoqi amendamentin e propozuar nr. 60.

Deputetët: Adem Salihaj, Milazim Haliti, Blerim Grainca, Synavere Rysha, Ali Sadriu dhe Danush Ademi, e tërhoqën amendamentin e propozuar nr. 62.

Deputetët: Bekim Haxhiu, Flora Brovina dhe Besa Gaxherri, diskutuan në lidhje me amendamentet me numër: 20, 21 dhe 22.

Në lidhje me amendamentin nr. 17 diskutuan deputetët: Shaip Muja dhe Naser Osmani.

Në lidhje me amendamentin nr. 20 dhe për Projektligjin diskutuan edhe: Labinotë Demi-Murtezi, Shaip Muja, ministri Avdullah Hoti dhe zv/kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, Kryetari hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2016, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	78,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

Ministri Avdullah Hoti, tha se nëpërmjet këtij Projektligji, ratifikohet Marrëveshja për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10, nga kufiri me Serbinë deri në kufi me IRJ të Maqedonisë.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm 4 nene.

Në fund, ministri ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij Projektligji, kërkon së paku, 80 vota “Për”, dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Në fund, Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë dhe se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim.

Ai procedoi me pikat vijuese.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë.

Ministri Avdullah Hoti, tha se nëpërmjet këtij Projektligji, ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë, e cila mundëson realizimin e kredisë në vlerë deri në 12 milionë €.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm 4 nene.

Në fund, ministri ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij Projektligji, kërkon së paku, 80 vota “Për”, dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim.

Ai procedoi me pikat vijuese.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin Marrëveshjes së kredisë Kosovë-Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK.

Ministri Arban Abrashi, tha se nëpërmjet këtij Projektligji, ratifikohet Marrëveshja për kredinë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK, e cila i mundëson Qeverisë së Kosovës realizimi i kredisë deri në 2, 6 milionë €.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm 4 nene.

Në fund, ministri ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kredinë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK.

Fjala e ministrit Arban Abrashi, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij Projektligji, kërkon së paku, 80 vota “Për”, dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim.

Ai procedoi me pikat vijuese.

8. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike tha se në pajtim me nenin 144 paragrafi 1 të Kushtetutës, Qeveria e Kosovës ka ri-proceduar Propozim-amendamentin nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky Propozim-Amendament është i vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me Aktgjykim nr. AGJ 303/12, datë 31 tetor 2012.

Më tej, Kryetari i Kuvendit ftoi Ministrin e Drejtësisë Hajredin Kuçi për paraqitjen dhe arsyetimin para Kuvendit, të Propozim-Amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Hajredin Kuçi tha se me qëllim të përmbushjes së kritereve që ndërlidhen me agjendën evropiane, Ministria e Drejtësisë ka propozuar amendamentin nr. 25 në Kushtetutën e

Republikës së Kosovës sa i përket numrit dhe zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë amendament është propozuar që të rritet numri i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga pesë në shtatë të zgjidhen nga anëtarët e gjyqësorit dhe nga katër anëtarë që parashihet në Kushtetutë të zgjidhen nga Kuvendi, me këtë propozim-amendament parashihet të zgjidhen dy anëtarë.

Fjala e ministrit z. Hajredin Kuçi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Selviqe Halimi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim.

Ai procedoi me pikat vijuese.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Ministri Kujtim Shala, tha se ky projektligj parasheh masat për parandalimin e dhunës dhe sjelljeve të palejuara gjatë ngjarjeve sportive, si dhe kompetencat e organeve zyrtare për shqiptimin e masave për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Kujtim Shala është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani – në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, Bekim Haxhiu- në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Salih Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	66,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Kuvendi ngarkoi Komisionin funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare.

Në emër të Qeverisë askush nuk e paraqiti ekspozenë për këtë Projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Sala Berisha-Shala – në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	68,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115

Kryetari e njoftoi Kuvendin se Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përsheptuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, e ka përkrahur kërkesën e Kryeministrit, Mustafa, që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të behet më procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara më Rregulloren e Kuvendit.

Muhamet Mustafa kryetar i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, paraqiti propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për shqyrtim dhe miratimin në parim dhe për shqyrtimin e dytë të Projektligjit në fjalë.

Më pas, kryetari hodhi në votim propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për shqyrtimin dhe miratimin në parim dhe për shqyrtimin e dytë të Projektligjit në fjalë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 0
Abstenime----- 0

Kryetari konstatoi ser Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Për shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9, të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, të bëhet në seancën plenare më 14 dhjetor 2015.
2. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 të bëhet në seancën tjetër plenare, e cila mbahet më 14 dhjetor 2015.

Pas miratimit të Vendimit të lartpërmendur, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115.

Kryeministri Isa Mustafa, tha se ky Projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të caktuara në ligj me qëllim të sqarimit të emërimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit pasi që mandati i anëtarëve ndërkombëtarë ka qenë deri më 31 gusht 2014 dhe në ligj nuk është përcaktuar qartë se si do të veprohet me këto pozita, pas datës 31 gusht 2014.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e kryeministrit Isa Mustafa, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Armend Zemaj dhe Raif Qela, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-062 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115.

Kuvendi ngarkoi Komisionin funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandime për seancën plenare të radhës e cila do të mbahet në orën 22:00, dt. 14 dhjetor 2015.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Armend Zemaj.

Fjala e deputetëve: Muhamet Mustafa dhe Armend Zemaj, është dhënë e plotë në transkript.

Amendamentet 1 dhe 2 u miratuan në formën e modifikuar sipas diskutimeve të deputetit Armend Zemaj.

Kuvendi miratoi amendamentet: 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	60,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-051 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për dizajnin industrial.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	66,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-058 për dizajnin industrial.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	68,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për provimin e maturës shtetërore.

Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Në lidhje me amendamentin 17 diskutoi deputeti Bekim Haxhiu.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 33.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	60,
Kundër -----	8,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	61,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Energjinë Termike

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për Energjinë Termike.

Fatmir Rexhepi, anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	63,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-052 për Energjinë Termike.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Në lidhje me këtë Projektligj diskutuan: ministri Arsim Bajrami, Nait Hasani, Salih Morina, Enver Hoxhaj, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi dhe ministri Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, dhe 12 të formuluar sipas propozimit të ministrit Arsim Bajrami.

Kuvendi miratoi amendamentet: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221, Nr.04/L-116 dhe Nr.04/L-194

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221, Nr.04/L-116 dhe Nr.04/L-194.

Në lidhje me amendamentin nr. 6 dhe për këtë Projektligj diskutuan: Naim Fetahu dhe Naser Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 3, 4 dhe 5.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 2.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221, Nr.04/L-116 dhe Nr.04/L-194.

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237.

Në lidhje me amendamentin nr. 13 diskutuan deputetët: Armend Zemaj dhe Naser Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar mos miratimin e tij.

Në lidhje me këtë Projektligj diskutuan: Armend Zemaj- në emër të Komisionit Funkcional dhe ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 0,
Kundër ----- 61,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Ligjin nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Në lidhje me këtë Projektligj Kryetari theksoi se për fjalë është paraqitur zv/kryeministri Kujtim Shala.

Kujtim Shala, tha se në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës e tërheq këtë Projektligj, për arsye të disa konsultave shtesë që duhet të bëhen.

Kryetari konstatoi se Qeveria e Republikës së Kosovës e tërheq këtë Projektligj nga procedurat parlamentare.

23. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Në lidhje me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, Muhamet Mustafa – kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që të bëhet pauzë dhe Komisioni të bëjë shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115, dhe Kuvendit ti paraqet Raportin me rekomandime për shqyrtim në një seancë plenare të re, sipas Vendimit të Kuvendit të përcaktuar në pikën nr. 11. të rendit të ditës.

Në lidhje me këtë çështje diskutoi edhe kryeministri Isa Mustafa.

Kryetari konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës vazhdohet pas mbajtjes së seancës plenare të radhës.

24. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për emërimin anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE

Kryetari tha se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit Funkcional dhe deputeti Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen anëtarët e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si në vijim:

1. Arsim Janova,
2. Qemajl Mustafa, dhe
3. Besim Sejfiqaj.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij Vendimi, zgjat pesë (5) vjet.

25. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për emërimin anëtarëve në Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare – ARKEP

Kryetari tha se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit Funkcional dhe deputeti Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,

Kundër----- 3,

Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen kryetari anëtarët e Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, si në vijim:

1. Kreshnik Gashi, kryetar,
2. Nijazi Ademaj, anëtar,
3. Hazir Hajdari, anëtar,
4. Bahri Anadulli, anëtar,
5. Shqiprim Pula, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij Vendimi, zgjat pesë (5) vjet.

26. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit

Kryetari i njoftoi deputetët për Raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Deputetët: Teuta Sahatqija dhe Luljeta Veselaj-Gutaj në emër të Komisionit Funkcional e paraqitën dhe arsyetuan para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji.

Diskutimi i deputetes Teuta Sahatqija dhe Luljeta Veselaj-Gutaj, është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

27. Propozimi për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ankesave në Komisionin e Pavarur për Media

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 8 dhjetor 2015, ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri me datë 11 dhjetor 2015 të propozojnë kryetarin, zv/kryetarët dhe anëtarët, për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa në Komisionin e Pavarur për Media.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryetari hodhi në votim propozimet për kryetar, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Ankesa në Komisionin e Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni Ad- hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Ankesave në Komisionin të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Luljeta Veselaj-Gutaj nga PDK, kryetare,
2. Sadri Ferati nga LDK, zëvendëskryetar i parë,

3. Kujtim Paqaku nga , nga “6+”, zëvendëskryetar i dytë,
4. Hajdar Beqa nga PDK, anëtar,
5. Adem Salihaj, nga LDK, anëtar,
6. _____, nga “Vetëvendosje”, anëtar,
7. Jelena Bontiq, nga LS, anëtare,
8. _____, nga AAK, anëtar,
9. _____, nga NISMA, anëtar.

II. Komisioni parlamentar Ad-hoc, në bazë të nenit 38 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, duhet t’i shqyrtoi dhe t’i përzgjedh kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur për Media.

28. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin parlamentar.

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar zëvendësimin në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kuvendi, me propozim të Grupit Parlamentar të PDK-së, mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Adem Grabovci, tërhiqet nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe emërohet anëtar në Komisionin parlamentar për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Latif Gashi.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 20:50 minuta.

* * *

17 dhjetor 2015, ora 12:30
Vazhdimi i seancës, e filluar më 14 dhjetor 2015

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar më 14 dhjetor 2015.

Ai procedoi me pikat si në vijim:

5. Votimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur me 14 dhjetor 2015, ndërsa në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyer për seancën e sotme.

Në sallë ishin të pranishëm 75 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë pikë të rendit të ditës.

Më tej, kryetari konstatoi se mungesa e kuorumit për procedimin me votim ka të bëjë edhe me tri (3) pikat e rendit të ditës, si në vijim:

6. Votimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huasë,

7. Votimi i Projektligjit për ratifikimin Marrëveshjes së kredisë Kosovë-Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK, dhe

8. Votimi i Propozim-Amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Më pas kryetari procedoi me pikën e fundit të mbetur të vazhdimit të kësaj seance:

23. Votimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur me 14 dhjetor 2015, ndërsa në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyer për seancën e sotme.

Në sallë ishin të pranishëm 73 deputetë.

Kryetari më pas hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:

1. Petrit Gashi, kryesues,
2. Hasime Mazreku, anëtare,
3. Hamdi Jaha, anëtar,
4. Skender Komoni, anëtar,
5. Ismail Jonuzi, anëtar,
6. Haxhi Arifi, anëtar,
7. Ranko Djokiq, anëtar
8. Bajram Zejnullahu, anëtar.

Në fund, kryetari i njoftoi deputetët se, në pajtim me nenin 37 të Rregullores, me këtë seancë përmbyllet Sesioni vjeshtor i punimeve të Kuvendit, ndërsa Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar 2016.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:08 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Përgatiti: Selman Ymeri,
Zyrtar i lartë ligjor*